

VENDIM
Nr. 17, datë 15.1.2020

**PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E
PROGRAMEVE TË NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET PUNËSIMIT,
FORMIMIT NË PUNË DHE PRAKTIKAVE PROFESIONALE**

*(ndryshuar me VKM nr. 798, datë 12.10.2020 ; nr. 194, datë 31.3.2021; nr. 266, datë 29.4.2022 ; nr.
239, datë 17.4.2024)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, “Për
nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të mëposhtme të nxitjes së punësimit:

- a) programit të punësimit;
- b) formimit nëpërmjet punës;
- c) praktikave profesionale.

2. Programet, sipas pikës 1 të këtij vendimi, zbatohen në përputhje me nevojat individuale të punëkërkuësit për t’u integruar në tregun e punës dhe në planin individual të integruar për punësimin e tij.

3. Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit përcakton çdo vit prioritetet dhe miraton planin e zbatimit të fondeve të nxitjes së punësimit, sipas pikës 1 të këtij vendimi, pas propozimit nga drejtoria e përgjithshme e institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë.

II. KRITERET E KËRKESËS

1. Punëkërkuësit me të drejtë përfitimi janë të gjithë punëkërkuësit e papunë të regjistruar dhe aktivë, për jo më pak se 1 (një) muaj në zyrën e punës, pasi të kenë marrë shërbimet e nevojshme të punësimit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi nga specialisti përkatës i punësimit. *Përjashtim nga ky kriter bëjnë vetëm të rinjtë, të moshës 15–29 vjeç, të cilët do të jenë pjesëmarrës sipas skemës së garancisë rinore dhe personat me aftësi të kufizuara.* Nevojat dhe profili i punëkërkuësit duhet të përshtaten me kërkesat për aftësi të vendit të lirë të punës të ofruar nga punëdhënësi.

2. Punëkërkuësi, pjesëmarrës në programet, sipas pikës 1 të këtij vendimi, nuk mund të zëvendësohet.

3. Një punëkërkuës mund të marrë pjesë vetëm një herë në të njëjtin program brenda një periudhe pesëvjeçare.

4. *Punëdhënësit me të drejtë kërkesë duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:*

- a) *Të jenë persona fizikë apo juridikë të regjistruar, për jo më pak se 6 (gjashtë) muaj;*
- b) *Subjekti të jetë në statusin aktiv;*
- c) *Të mos kenë shkelur legjislacionin për punësimin në dy vjetët e fundit para kërkesës në program;*
- d) *Të ofrojnë punë me kohë të plotë, për një minimum prej 40 (dyzet) orësh në javë, me një pagesë mujore jo më pak se paga minimale, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës. Punësimi me kohë të pjesshme ose punët sezonale afatshkurtra nuk përfshihen në subvencionim;*

d) Të jenë persona fizikë apo juridikë, të cilët nuk kanë detyrime të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, por në momentin e aplikimit në program kanë ende gjoba apo interesa të papaguar.

dh) Vendi i punës i financiar nga ky program duhet të vijë si rezultat i shtimit të vendeve të lira të punës në aktivitetin e punëdhënësit.

5. Punëdhënësit kanë të drejtë të aplikojnë në një ose më shumë se një program për një numër punëkërkuesish jo më të madh se 20 (njëzet) % të fuqisë punëtore aktuale, por jo më shumë se 21 (njëzet e një) pjesëmarrës. Punëdhënësit me deri në 9 (nëntë) punonjës mund të aplikojnë për maksimumi 2 (dy) pjesëmarrës.

III. PROGRAMET, PËRFITUESIT DHE MBËSHTETJA

1. Programi i punësimit përmban elementet e mëposhtme:

a) programi i punësimit është një program njëvjeçar punësimi, në të cilin profili dhe nevojat e punëkërkuesit përshtaten me vendin e lirë nga punëdhënësi;

b) paga përcaktohet në kontratën e punës, në përputhje me pozicionin përkatës dhe nivelin e pagave në treg;

c) punëkërkuesit e papunë me të drejtë përfitimi nga programet, sipas pikës 1 të këtij vendimi, janë nga kategoritë e mëposhtme:

i. të rinjtë me moshë nën 29 (njëzet e nëntë) vjeç;

ii. punëkërkuesit e papunë afatgjatë;

iii. punëkërkuesit me moshë mbi 45 (dyzet e pesë) vjeç;

iv. punëkërkuesit e papunë të pakualifikuar;

v. punëkërkues të papunë, të kthyer prej jo më shumë se 2 (dy) vjetësh nga emigracioni;

vi. punëkërkuesit që përfitojnë ndihmë ekonomike, duke trajtuar me prioritet përfituesit e ndihmës ekonomike, që parashikohet të dalin nga skema e ndihmës ekonomike në vitin përkatës dhe atë pasardhës;

vii. punëkërkuesit që marrin pagesa papunësie për më shumë se 3 (tre) muaj;

viii. personat me aftësi të kufizuara;

ix. viktimat e trafikimit, të dhunës me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje;

x. punëkërkuesit nga komuniteti rom dhe egjiptian;

xi. personat që kanë përfunduar kursin e formimit profesional ose programin e formimit nëpërmjet punës dhe janë ende të papunë 6 (gjashtë) muaj pas përfundimit;

ç) programi subvencionon kostot e mëposhtme:

i. kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë të gjithë kohëzgjatjes së punësimit, të kompensuara çdo muaj;

ii. financimin e pagës në shumën 100 (njëqind) % të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi:

- për 6 (gjashtë) muaj, për pjesëmarrësit, të cilët janë të rinj të moshës 15–29 vjeç, persona me aftësi të kufizuara, viktimat e trafikimit, të dhunës në familje apo viktimat e dhunës me bazë gjinore, romë dhe egjiptianë, të kompensuara në muajin e katërt, të pestë, të gjashtë, të shtatë, të njëmbëdhjetë dhe të dymbëdhjetë të kontratës.

- Shfuqizuar.

- për 12 (dymbëdhjetë) muaj për pjesëmarrësit, persona me aftësi të kufizuara, të kompensuara çdo muaj.

2. Programi i formimit nëpërmjet punës përmban elementet e mëposhtme:

a) programi i formimit nëpërmjet punës ka si qëllim trajnimin në punë të punëkërkuesve, sipas nevojave të profilit të punës të kërkuar nga punëkërkuesit dhe përshtatur me nevojat e punëdhënësit;

b) kohëzgjatja e subvencionimit të ofruar nga ky program do të jetë për një periudhë katërmujore për të gjitha profesionet;

c) plani individual i trajnimit hartohet nga punëdhënësi e miratohet nga strukturat përkatëse të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë;

ç) çdo punëdhënës cakton të paktën një trajner për çdo grup përfituesish, nga një deri në shtatë persona përfitues, të përfshirë në program;

d) përfitues i këtij programi është punëkërkuesi i papunë dhe i pakualifikuar në profesionin e interesuar;

dh) programi subvencionon kostot e mëposhtme:

i. kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë gjithë kohëzgjatjes së formimit, të kompensuara çdo muaj;

ii. financimin e pagës në shumën 100 (njëqind) % të pagës minimale në shkallë vendi të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, të kompensuara çdo muaj;

iii. kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit) për tetë muajt e ardhshëm, të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, në rastet, kur, pas përfundimit të formimit nëpërmjet punës, punëdhënësi lidh kontratë punësimi të paktën tetëmuajore me punëmarrësin pas përfundimit të programit, *të kompensuar çdo muaj*;

iv. *pagesën për mentorin në vlerën 3 000 (tre mijë) lekë për çdo përfitues, pjesëmarrës të angazhuar nga ky punëdhënës, të kompensuar çdo muaj.*

3. Programi i praktikave profesionale përmban elementet e mëposhtme:

a) *Programi i praktikave profesionale ka si qëllim të garantojë tranzicion të shpejtë në tregun e punës, në të njëjtën fushë ose në një fushë të ngjashme me atë, në të cilën ka studiuar i diplomuari ose nxënësit e diplomuar në shkollat e mesme profesionale publike apo private, për një kohëzgjatje 6-mujore;*

b) përfitues të këtij programi janë të gjithë punëkërkuesit e papunë, të cilët janë të sapodiplomuar, deri në 36 (tridhjetë e gjashtë) muajt e fundit pas diplomimit, të cilët janë regjistruar si punëkërkues të papunë;

c) programi subvencionon kostot e mëposhtme:

i. kontributet për sigurimin nga aksidentet në punë;

ii. financim i pagës në shumën 50 (pesëdhjetë) % të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, të kompensuara çdo muaj.

4. Përveç subvencionimit të kostove të mbuluara nga këto programe, të përcaktuara në pikat 1, 2 e 3, të këtij kreu, për përfituesit jetimë, prindër të vetëm me fëmijë nën 6 (gjashtë) vjeç, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, viktimat e viktimat e mundshme të trafikimit, viktimat e dhunës në familje ose të dhunës me bazë gjinore, *përfituesit e rinj të moshës 15–29 vjeç, personat me aftësi të kufizuara dhe përfitues të ndihmës ekonomike mbulohen edhe shpenzime të tjera, si më poshtë vijojnë:*

a) bonuse për shpenzimet e transportit mbulohen për të gjitha kategoritë e mësipërme, të cilat kanë vendbanimin mbi 2 (dy) km nga vendi i punës, në vlerën prej 1 800 (një mijë e tetëqind) lekësh në muaj;

b) *për prindërit e vetëm ose prindërit e rinj të moshës 18–29 vjeç me fëmijë nën 6 (gjashtë) vjeç jepet një bonus në vlerën prej 4 000 (katër mijë) lekësh në muaj për kujdesin e çdo fëmije në ngarkim;*

c) deri në shumën 200 000 (dyqind mijë) lekë për përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës për personat me aftësi të kufizuara, *në të cilën përfshihen, por pa u kufizuar, mjetet ndihmëse në vendin e punës, literaturë/informacion të përshtatur dhe përkthime për personat me dëmtime shikimi ose dëgjimi, asistent personal në vendin e punës, transport të përshtatur, aksesueshmëri të mjedisit të punës për punëdhënësit.*

IV. RREGULLAT DHE PROCEDURAT E ZBATIMIT

Procedura e përgjithshme e zbatimit të këtyre programeve përfshin hapat, si më poshtë vijojnë:

1. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, nëpërmjet strukturave të tij, publikon informacionin e nevojshëm në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në platforma të tjera (faqe

interneti, media sociale, shtyp etj.) lidhur me zbatimin e programeve dhe informon rregullisht punëdhënësit e punëkërkuessit e regjistruar.

2. Punëdhënësit paraqesin kërkesën për përfshirjen në program nëpërmjet portalit “e-Albania”, duke ngarkuar dokumentacionin e mëposhtëm:

a) formularin e kërkesës të plotësuar, sipas modelit standard të miratuar dhe publikuar nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë;

b) autorizimin e punëdhënësit, me të cilin autorizohet institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë për të kryer të gjitha verifikimet dhe kërkimet e nevojshme të dokumenteve dhe të të dhënave të kërkesës;

c) vetëdeklarim për mospasjen në ngarkim të punëdhënësit, të shkeljeve apo të sanksioneve që lidhen me legjislacionin e punës, përgjatë dy viteve të fundit.

3. Pas marrjes së kërkesës nga punëdhënësi, verifikimet përkatëse për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në pikën 4, të kreut II, për punëdhënësin, do të kryhen nga Sistemi i Shërbimeve të Punësimit nëpërmjet ndërveprimit me bazën e të dhënave shtetërore të institucioneve të tjera.

4. Për punëdhënësit që plotësojnë kriteret, struktura vendore e punësimit, brenda 7 (shtatë) ditëve pune, identifikon listën e pjesëmarrësve punëkërkuess të papunë, që plotësojnë kriteret e pjesëmarrjes në program.

5. Në rast të mosplotësimit të kushteve paraprake, struktura vendore e punësimit i kërkon kërkuessit plotësimin e dokumentacionit.

6. Në rast të plotësimit të kushteve paraprake, struktura vendore i përcjell për miratim kërkesën strukturës rajonale të punësimit, e cila, brenda 5 (pesë) ditëve pune, vendos miratimin ose mosmiratimin e projektit, sipas rregullave të përcaktuara në manualin e zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit.

7. Struktura vendore e punësimit i komunikon punëdhënësit kërkuess përgjigjen përfundimtare për pranimin apo refuzimin e kërkesës brenda 2 (dy) ditëve pune.

8. Punëdhënësi dhe punëkërkuessi, në cilësinë e punëmarrësit, lidhin një kontratë pune, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e secilës palë, në përputhje me programet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi. Një kopje e kontratës së punësimit dorëzohet në strukturën vendore të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, i cili do të monitorojë zbatimin e saj deri në përfundim të projektit.

9. Pas nënshkrimit të kontratës së punës nënshkruhet marrëveshja trepalëshe për zbatimin e programit.

10. Për pjesëmarrësit në program, të cilët kanë qenë përfitues të ndihmës ekonomike, institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë informon institucionin përgjegjës për shërbimin social.

11. Nëse punëdhënësi zgjidh në mënyrë të njëanshme kontratën me përfituesin, punëdhënësi është i detyruar të kthejë 100 (njëqind) % të mbështetjes financiare të përfituar deri në atë moment.

12. Nëse punëdhënësi nuk respekton marrëveshjen trepalëshe për zbatimin e programeve, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ai përjashtohet nga pjesëmarrja në program për një periudhë katërvjeçare.

13. Financimi i punëdhënësit do të bëhet çdo muaj, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, pas dorëzimit të kërkesës për muajin që kërkon financim.

14. Monitorimi i zbatimit kryhet nga strukturat përkatëse të punësimit (institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë).

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë përgatit raportin vjetor brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe ia paraqet ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe strukturës përgjegjëse të ndihmës shtetërore.

2. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë ruan të dhënat për programet 10 (dhjetë) vjet, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

3. Vlerësimi i ndikimit të programeve kryhet çdo 4 (katër) vjet nga ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit, nëpërmjet ekspertëve ose organizatave me përvojë në këtë fushë.

4. Afati i zbatimit të programeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, është *10 (dhjetë)* vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

5. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 11.1.2012, “Për programin e nxitjes së punësimit të grave dhe të vajzave nga grupet e veçanta”, i ndryshuar; nr. 47 datë 16.1.2008, “Për programet e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë nëpërmjet formimit në punë”, i ndryshuar; nr. 48, datë 16.1.2008, “Për programet e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë nga grupet e veçanta”, i ndryshuar; nr. 64, datë 27.1.2016, “Për programin e nxitjes së punësimit të rinjve që kanë fituar statusin e jetimit”, i ndryshuar; nr. 162, datë 21.3.2018, “Për pagesën e pjesëmarrjes në kurset e formimit profesional”; nr. 199, datë 11.1.2012, “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë të rinj”, i ndryshuar; nr. 248, datë 30.4.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara”, i ndryshuar; nr. 873, datë 27.12.2006, “Për programet e nxitjes së punësimit të praktikave profesionale për punëkërkuesit që kanë mbaruar arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit”, i ndryshuar, shfuqizohen.

6. Programet e miratuara me bazën ligjore, e cila shfuqizohet sipas pikës 5 të këtij kreu, vazhdojnë zbatimin, sipas kushteve të vendosura në momentin e miratimit të tyre.

7. Ngarkohet institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë për hartimin e rregulloreve të zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama